

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik për buxhetin afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë Z. Besmir Veli.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara te Bashkisë Delvinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me projektbuxhetin afatmesëm dhe atë të 2025.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në Njësinë Administrative Vergo dhe në bashki sipas kalendarit më poshtë:

	Data	Ora	Vendi
Fshatrat Van, Shijan, Stjar	09.10.2024	12.00	Shijan
Fshatrat Bamatat, Vllahat	14.10.2024	18.00	Bamatat dhe Vllahat
Qyteti dhe fshati Rusan	17.10.2024	18.00	Kinoteater
Fshatrat Leftrehor, Kakodhiq, Varfaj	21.10.2024	12.00	Leftrehor
Fshatrat Kalasë, Tatzat	24.10.2024	19.00	Kalasë
Fshatrat Fushë-Vërri, Senicë	25.10.2024	12.00	Senicë
Fshatrat Vergo, Kopaçez	28.10.2024	19.00	Vergo
Fshatrat Bajkaj, Palavli	29.10.2024	12.00	Bajkaj

Gjithashtu, sugjerimet e tyre janë të mirëpritura, në adresat e emaileve: keshillibashkiakdelvine@gmail.com dhe brunilda.meleqi@yahoo.com

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Kryetar i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, drejtues/punonjës të administratës, drejtorja e buxhetit dhe financës, sektori i tatim taksave, Kryetarët e Fshatrave dhe Administratorët e Njërive Administrative.
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Delvinë, anëtarët e shoqërisë civile, OJF dhe Media, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitare, grupe interesi etj.

Forma e konsultimit: Takime në terren.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik në terren synon konsultimin për buxhetin afatmesëm 2025-2027, si dhe diskutime mbi buxhetin e vitit 2025.
Përshkrimi i çështjes.	Miratimi i draftit të projekt buxhetit afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve mbi draftin e buxhetit afatmesëm 2025-2027. Gjithashtu, ndryshimet e mundshme apo jo te taksave dhe tarifave në paketën fiskale janë një element shumë i rëndësishëm dhe proces i cili duhet të kalojë përmes konsultimit të gjerë në publik.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak: keshillibashkiakdelvine@gmail.com dhe brunilda.meleqi@yahoo.com BRENDA DATËS 15.10.2024
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit : Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.
Projekt-vendimi, relacioni shoqëruar, në lidhje me çështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë.
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Dërgimi i sugjerimeve të komunitetit do të jetë i mundur deri në datën 15.10.2024 nëpërmjet adresave të emailit: keshillibashkiakdelvine@gmail.com Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar) të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projektbuxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor; 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit;

	<ol style="list-style-type: none">6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar;9. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	02.10.2024